

UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT  
VENDIM

Nr. 10, datë 15 /04 /2019

MBI

**“MIRATIMIN PARAPRAK, PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT  
PERKUSION, CIKLI I PARË BACHELOR, NË FAKULTETIN E MUZIKËS TË  
UNIVERSITETIT TË ARTEVE”**

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 13, datë 09.04.2019 “Mbi Miratimin paraparak, për hapjen e programit të studimit Perkusion, në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve”; Udhëzimin e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 31, datë 29.12.2017 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë” dhe pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Fakulteti i Muzikës, pasi e diskutoi me votim të hapur,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin paraparak, për hapjen e programit të studimit Perkusion, në Fakultetin e Muzikës të Universitetit të Arteve, sipas materialit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit së Arsimit Sportit dhe Rinisë për miratim përfundimtar.
3. Publikimin e vendimit në faqen zyrtare (internet) të Universitetit të Arteve dhe te transparenca.

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE**

**Prof. Besnik BISHA (Kryetar)**

**Risena XHAJA (Anëtar)**

UNIVERSITETI I ARTEVE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Prof. Arben BASHA (Anëtar)

Aida MARTIRO (Anëtar)

Prof. Artan PEQINI (Anëtar)

Prof. Bujar KAPEXHIU (Anëtar)

Lorenc VANGJELI (Anëtar)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS

Nr. 148 Prot.

Tiranë më 12. 04. 2019

**LËNDA: RELACION PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË STUDIMIT PERKUSION,  
CIKLI I PARË BACHELOR**

**Drejtuar: Bordit të Administrimit**

**Universiteti i Arteve**

**Sheshi Nënë Tereza**

Po ju parashtroj propozimin për hapjen e programit të studimit "Perkusion" në ciklin e parë Bachelor për motivet si më poshtë:

1. Perkusioni është një nga seksionet më të rëndësishëm për çdo orkestër apo ansambël që nga orkestrat simfonike, orkestrat frymore apo ansamblet e ndryshme muzikore;
2. Është një nga programet e studimit e kërkuar nga kandidatët për student të cilët më pas tentojnë ti kryejnë këto studime jashtë;
3. Nevoja e domsdoshme e tregut të punës në Shqipëri

Të diplomuarit në programin e studimit "Perkusion" për shkak edhe të mungesës për një kohë të gjatë të një programi studimi specifik, kanë krijuar një hapsirë të gjerë dhe të pa mbuluar në drejtim të punësimit të tyre në Institucionet Qendrore Kulturore, ato Lokale, institucionet arsimore po ashtu dhe në sektorin privat si:

- Orkestra e TKOB-së;
- Orkestra simfonike e RTSH-së;
- Orkestra Frymore e FA;
- Orkestrat frymore të bashkive;
- Shkollat artistike shtetërore dhe private;
- Ansamblet apo grupet muzikore të muzikës klasike dhe asaj modern etj

4. Çdo shkollë e nivelit universitar në të gjithë botën e ka të përfshirë këtë program studimi të rëndësishëm duke na bërë ne (UART) të vetmin institucion arsimor që nuk e ka;
5. Departamenti i Interpretimit dhe Fakulteti i Muzikës i ka të gjitha kushtet për ta hapur këtë program si në drejtim të personelit akademik ashtu dhe në drejtim të infrastrukturës dhe bazës materiale;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
FAKULTETI I MUZIKËS

6. Kostoja e programit do të jetë e njëjtë me studentët e frymës pasi në të gjitha lëndët kolektive, studentët e perkusionit do ti bashkangjiten atyre të frymës; (do të ketë një numër të kufizuar studentësh në vit, 1-4 studentë)
7. Departamenti i Intepretimt, Departamenti i KMDP-së në bashkëpunim me titullarët e lëndëve si dhe me mbështetjen e Dekanit, kanë hartuar Planin Mësimor dhe Syllabus-et për programin e studimit Perkusion sëbashku me përcaktimin e infrastrukturës së nevojshme.

**Në përfundim**

Nisur nga argumentet e paraqitura si më sipër, mendoj se hapja e programit të studimit “Perkusion” do të ishte një hap i rëndësishëm për shkollën tonë të interpretimit instrumental si një nga seksionet më të rëndësishëm të çdo formacioni profesionist muzikor.

Gjithashtu, nevojat e tregut të punës e bëjnë të domosdoshëm hapjen e këtij programi.

Prof. Arben Llozi

Përgjegjës i Njesisë Bazë të DI



Prof.Dr. Isak Shehu

Dekan i FM-së